

FORMULARI TIP I

Date: \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË  
KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV  
KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR  
ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË  
FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B**

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; Aplikim për Leje Mjedisore Tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; "Reden" s.p.k; Nr. ipti: K87530901G
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Dibër, Burrel, Lagjia Partizani, Bruga Hoxhe Kurti.
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; Udhëtimi i Hidrocentralit "Gjoni".
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; —
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Sali Kurti

Nr.kontakti

0697487976



## PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

### E RAPORTIT PARAPRAK TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS NDERTIM I HIDROCENTRALIT GJONI



*Në segmentin lumor ndërmjet kuotave 256  
dhe 165 m, në trungun e përroit të Lusës,  
MAT*

Investitor:



"REDEN" Sh.p.k

Hartoi raportin:



"GO GREEN STUDIO" Sh.p.k



## PERMBAJTJA

### 1. HYRJE

### 2. KUADRI LIGJOR

### 3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- Pozicioni fiziko-gjeografik
- Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit
- Karakteristikat klimaterike
- Karakteristikat hidrografike
- Regjimi hidrologjik, rrjedhja ujore
- Kushtet gjeologo-inxhinierike te zones
- Kushtet gjeologo-inxhinierike te veprave hidroteknike
- Pershkrimi i veprave hidroteknike
- Lidhja e hidrocentralit me rrjetin energjetik
- Impakti ne mjedis I ndertimit te linjes se transmetimit
- Infrastruktura rrugore e zones dhe rruget ndihmese

### 4. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

- Statusi i zones ne studim
- Variantet e zhvillimit ne perspektive
- Mendimi i komunitetit
- Planet e zhvillimit urban te zones
- Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues
- Trashegimia arkitektonike dhe historike

### 5. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

- Ndikimet ne mjedis gjate ndertirnit te veprave te rnarrjes se ujit dhe godines se hidrocentralit. Ndikimet ne mjedis gjate pergatitjes se veprave te rnarrjes dhe transmetirnit te ujit per ne hidrocentral
- Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe dote largohen nga kanale, tunelet, linjat e shtrirjes se tubacioneve, etj.

- Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshrne per ndertimin e veprave hidroteknike te hidrocentralit
- Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese
- Zhurmat
- Ndikimet ne ujrat siperfaqesore
- Ndikimet ne ujrat nentokesore

## 6. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE DHE REHABILITIMET

- Perdorimi i tokes
- Ndikimi te njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu
- Ndikimi ne peisazh
- Ndikimet e hidrocentralit mbi trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe vepra te tjera njerezore
- Ulja e intesitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise

## 7. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLGJINE

- Bimet e ujit
- Flora dhe fauna
- Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike, roblemi i mjedisit gjeologjik

## 8. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

- Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj. Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones
- Ndikimet ne cilesine dhe sasine e tokes
- Ndikimet ne uje
- Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit
- Ndikimet ne ajer Ndikimi ne klime Aromat sulmuese
- Ndikime te tjera klimatike
- Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare qe shoqerojne projektin
- Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara

## 9. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

- Organizimi
- Masat e sigurimit teknik
- Mbrojtja e mjedisit
- Masat e marra per zbutjen e rrezikutne mjedis dhe shendet

## 10. RREZIKU NE MJEDIS I LINJES SE TRANSMETIMIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE TE PRODHUAR DHE MASAT ZBUTESE TE TYRE

- Ndikimet ne mjedis gjate fazes se operimit
- Rrymat endogjene dhe risku i tyre
- Efektet biologjike te fushave elektromagnetike
- Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare

## 11. MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- Matrica e ndikimeve ne mjedis
- Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe te shfrytezimit

## 12. ASPEKTET EGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- Efektet negative
- Efektet pozitive

## 13. PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT

- Plani i monitorimit
- Programi i monitorimit
- Plani i monitorimit gjate operimit

## 14. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## 1. HYRJE

Ky projekt i nenshtrohet VNM Paraprake ne baze te **Ligjit 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, Shtojca II, pika 3-të) Instalime per prodhimin e energjise hidroelektrike**

Ne vijim, Tabela 1, e Aneksit I, të udhëzimit . Nr.6, datë 27.12.2006. “Për Miratimin e Metodologjisë të Vlerësimit Paraprak të Ndikimeve në Mjedis të një Veprimtarie“ te Ministrise se Mjedisit.

**Kjo tabelë përmban një sërë kërkesash që ndihmojnë për të vlerësuar nëse një projekt do të ketë ndërveprime me mjedisin, si dhe për të vendosur nëse një veprimtari do të ketë apo jo ndikime potenciale/thelbësore në elementet përbërëse të mjedisit.**

Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikimin	Po / Jo /? Përshkruaj shkurtimisht	Do të ketë ndërveprim/ndikim të rëndësishëm? Po / Jo /?-Përse ?
<b>Gjatë zbatimit të projektit apo ushtrimit të veprimtarisë:</b>		
<b>1. Do të shkaktohen ndryshime fizike në territor (në topografinë, përdorimin e tokës ose burimet ujore etj.)?</b>	<b>PO</b> (Lidhen me ndertimet e veprave hidroteknike)	<b>JO</b> (Ndërtimi i veprave do te shoqerohet me rehabilitimin e tokes, eshte i kushtezuar plotesimi I nevojave me uje i komunitetit).
2. Do të përdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, veçanërisht ato burime që nuk janë të rinovueshme ose me pakicë?	<b>PO</b> (Toka si element i vendosjes se veprave, uji si burim energjie)	<b>JO</b>
3. Parashikohet përdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Nuk perdoren materiale dhe substancate demshme per shendetin dhe mjedisin)
4. Do të prodhohen mbetje të ngurta?	<b>PO</b> (Gjate ndertimit te veprave hidroteknike)	<b>JO</b> (Te gjitha mbetjet e ngurta do te transportohen)

5. Do të ketë shkarkime në ajër të ndotësve, substancave të rrezikshme, toksike ose helmuese?	<b>JO</b>	<b>JO</b> ( Nuk ka asnje lloj shkarkimi ne ajer)
6. Do të ketë zhurma e vibrime apo çlirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?	<b>PO</b> (Zhurma gjate nderimit rrezatim elektromagnetik nga linjate TM.)	<b>JO</b> (Zona e ndertimit eshte e pabanuar, efektet elektromagnetike te linjave jane konsideruar ne projektin e linjes TM)
7. Do të ketë rrezik për ndotjen e tokës dhe të ujërave nga shkarkimi i ndotësve mbi sipërfaqen e tokës ose të ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose në det?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Nuk ka shkarkime te ndotesve)
8. Ka rrezik për aksidente që mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve apo në mjedis?	<b>PO</b> (Aksidente mund te ndodhin gjate ndertimit)	<b>JO</b> (Jane vende kushte per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik ne pune)
9. Do të ketë ndikime sociale (demografike, në mënyrën tradicionale të jetesës, në punësimin e njerëzve etj.)?	<b>PO</b> (Hapje vende pune, permirsim i kushteve te jeteses)	<b>PO</b> (Impakt pozitiv)
10. Ka faktorë të tjerë që duhen marrë në konsideratë si zhvillime të njëpasnjëshme që mund të çojnë në pasoja në mjedis apo mundësi për mbivendosje ndikimesh të ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose të planifikuara në zonë?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (nuk ka asnje faktor tjetër)
11. Ka zona të mbrojtura nga legjislacioni ndërkombëtar/kombëtar për vlerat e tyre të biodiversitetit, ekologjike, peizazhistike ose me vlera kulturore, historike e arkeologjike në zonë?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Impakti i prodhimit te energjise elektrike do te ndertohet ne zonen e cila nuk ben pjese zona te permendura ne piken 11.)
12. Ka zona të ndjeshme mjedisore, si ligatina, zona bregdetare, male, pyje, kullota, florën e faunën e egër, dru frutorë etj. në zonë?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Ndertimi i hidrocentralit nuk do te shoqerohet me shpyllezim)

13. Ka zona me specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme, të kërcënuara, të rrezikuara, në rrezik zhdukjeje të faunës dhe florës, p.sh. për kryqëzime, folenizime, pushime, dimërimë, migrime etj. në zonë?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Ndertimi i hidrocentralit nuk cenon floren dhe faunen)
14. Ka zona me ujëra tokësore, nëntokësore apo detare në zonë?	<b>PO</b> (Lumi MAT)	<b>JO</b> (nuk ka nderveprim apo ndikim te rendesishem)
15. Ka zona me tipare të spikatura panoramike ose skenike në zonë?	<b>PO</b> (Zona eshte panorame)	<b>JO</b> (nuk ka nderveprim apo ndikim ne mjedis)
16. Ka rrugë apo infrastruktura të ngjashme që përdoren nga publiku për të shkuar në vende pushimi etj. ose rrugë transporti të mbingarkuara që mund të ndikohen?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (nuk ka nderveprim apo ndikim te rendesishem)
17. Ka përdorime ekzistuese të tokës (banim, industri, tregti, pushim, bujqësi, pyje, turizëm, zona të gjelbra, argëtuese, sportive, prona të tjera private etj.) ose plane të ardhshme që mund të ndikohen?	<b>JO</b>	
18. Është zona nën rrezikun e ndotjes ose dëmtimeve mjedisore (ku standardet mjedisore janë të tejkaluara)?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (nuk ka asnje lloj aktiviteti ne zone)
19. Është zona me probleme përsa i përket tërmeteëve, rrëshqitjeve të dheut, erozionit, përmytjeve, kushteve ekstreme klimatike (ndryshime të temperaturës, mjegulla, erëra të forta)?	<b>JO</b>	<b>JO</b> (Jane marre ne konsiderategjate projektimit te veprave hidroteknike dhe linjave te transmetimit)

**SHENIME:** Studimi për “Hidrocentralin “GJONI” në përroin e Lusës, degë të lumit Mat, Bashkia Burrel”, i kryer me kërkesë të investitorit “REDEN” Shpk, në kuadrin e hartimit të *Dosjes për Hidrocentralin që planifikohet të ndërtohet në segmentin lumor ndërmjet kuotave 253 dhe 165 m mbi nivelin e detit me vepër marrjeje në pikën e bashkimit të proit të Lusës me prroin e Zallit dhe ndërtesë të centralit në bregun e djathtë të lumit Mat, në afërsi të fshatit Shoshaj.*



Kërkesa për marrjen e këtij koncesioni bazohet në VKM 822 datë 07.10.2015, “**Për Miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni**”.

Studimi i parafizibilitetit është kryer nga studjot “Murtagj G.L. & Prohid” shpk, mbi bazën e të cilit është marrë edhe miratimi paraprak për ndërtimin e këtij HEC-i (shih dokumentin përkatës Nr.4098/5, datë 09.10.2017 në dosjen e përgjithëshme).

Sipas studimit të parafizibiliteti, uji parashikohet të merret në pikën e bashkimit të prroit të Zallit me prroit e Lusës, dhe nëpërmjet një derivacioni me gjatësi rreth 4.5 km, uji dërgohet në Basen të presionit në terracën lindore të luginës së lumit Mat, dhe më tej me anë të një tubacioni me gjatësi rreth 300m dërgohet në ndërtesë të centralit e cila ndërtohet në bregun e djathtë të lumit Mat në afërsi të fshatit Shoshaj. Sipas kësaj skeme shfrytëzohet një rënie ndërmjet kuotave 253 dhe 165m. Në pikën 4 të këtij raporti jepen detaje të përshtatjeve të bëra në periudhën ndërmjet dy studimeve.

## 2. KUADRI LIGJOR

### Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin

Ne Shqipëri fillimet e legjislacionit mjedisor shfaqen në vitin 1993 , vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përben dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikën mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudhën nga ky vit deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 mund ta konsiderojmë si etapën e parë të zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit. Mbas vitit 1998 e në vijim është periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian për mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar është në përsosje dhe pasurim të vazhdueshëm dhe zhvillimi i tij nuk i është len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian të mjedisit. Duke qenë se kushtetutat ravigejzojnë drejtimit e rregullimeve të ardhshme dhe

me të hollësishme që realizohen fillimisht me ligje dhe më pas me akte nënligjore edhe në rastin e vendit të Kushtetutës përben një fillesë dhe baze të rëndësishme lidhur me rolin që ka mjedisin për shoqërinë dhe shtetin të shtetit. Nisur nga përmbajtja e nënve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore mund të pohojmë se fryma e Kushtetutës sone është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike që u kushtojnë rëndësi të një niveli me të lartë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, sic janë e drejta për informimin e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshtatshëm për të jetuar jo vetëm brezat e sotëm por edhe ata në të ardhmen.

### ○ Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional

- VKM nr.686 date 29.7.2015 «**Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore** »

- *Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »*
- *VKM nr. 435 date 12.09.2015 « Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »*
- *VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.*
- *Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”*
- *VKM nr. 229 date 23.04.2014 “ Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jot e rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jot e rrezikshme”.*
- *VKM nr.371 date 11.06.2014 ‘Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”*
- *Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *VKM nr. 765 date 07.11.2012 “Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”*
- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Udhezimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhezim nr. 6527 date 24.12.2004 “Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre”*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.*
- *VKM nr.99 date 18.2.2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”*
- *Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*

### 3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

#### ○ Pozicioni fiziko-gjeografik

Në figurat 3.1 dhe 3.2 në vazhdim paraqitet pozicioni gjeografik i HEC GJONI në territorin e Shqipërisë, në rrethin e Matit dhe një korografi para e prapa zonës së projektit nga vepra e marrjes deri në ndërtesën e centralit.



Figura 3.1 Pozicioni që zë përro i Lusës në territorin e Shqipërisë






Figura 3.2 Pozicioni që zë projekti në Hartën e Rrethit të Matit



## KOORDINATAT



COORDINATAT		Vepra e Marrjes	Baseni I Presioit	Godina e Centralit "GJONI"
<b>KRGJSH</b>	E	505793.179	502927.931	502567.789
	N	4606606.845	4607048.311	4607343.307
<b>UTM ZONE 34N</b>	E	422449.197	419590.182	419233.597
	N	4605179.943	4605654.426	4605953.480
<b>ALBANIAN 1986/GK4</b>	E	4422549.0705	4419688.889	4419332.158
	N	4607154.206	4607628.884	4607928.059
<b>ETRS89/TM34</b>	( $\Delta$ )	422449.197	419590.182	419233.597
	( $\Phi$ )	4605179.943	4605654.426	4605953.480
<b>WGS 84</b>	( $\Delta$ )	20°04'10" E	20°02'06" E	20°01'50" E
	( $\Phi$ )	41°35'40" N	41°35'54" N	41°36'04" N
<b>WEB MERCATOR</b>	x	2234124.709	2230299.350	2229791.249
	y	5100438.108	5101032.108	5101413.841

Përroi i Lusës është njëra nga degët e pjesës së poshtme të lumit Mat, ai ka një pellg ujëmbledhës në derdhje me një sipërfaqe rreth 100.2 km<sup>2</sup>. Pellgu i këtij përroi shtrihet 100% në territorin e Shqipërisë.

Përroi i Lusës formohet nga rrjedhja e ujërave të reshjeve në faqen perendimore të malit të Dejës me kreshtë ndërmjet Majës së Runjës dhe Majës së Micekës me një lartësi 2047 dhe 2097m mnd respektivisht. Konfiguracioni i rumbullakosur i kreshtës së malit të Dejës dhe prezenca e disa liqeneve natyrore krijojnë një potencial të vlefshëm për grumbullimin e ujërave të shiut dhe sidomos ata të dëborës.

Morfologjia e pellgut ujëmbledhës nga burimet deri në derdhjen në lumin Mat paraqitet malore e me lugina vende vende, të thella e të ngushta.

Fotot 3.3 dhe 3.4 më poshtë paraqesin disa pamje ajrore të zonës ku janë identifikuar, kufijtë e pellgjeve ujëmbledhës,

Vepra e marrjes dhe Ndërtesa e **Centralit "Gjoni"**. Fotot 3.5 dhe 3.6 më poshtë paraqesin disa pamje të zonës ku do të ndërtohen Vepra e marrjes, Tubacioni i turbinave dhe ndërtesa e **HEC Gjoni**.




Foto 3.3. Pamje e Satelitore e Pellgut Ujëmbledhës të Lusës




Foto 3.4. Pamje satelitore e zonës ku do ndërtohen objektet e HEC Gjoni



Foto 3.5. Pamje e shtratit të Lusës në pikën e takimit të dy dëgëvë Kusë dhe Zall





Foto 3.6 Pamje e shtratit ku parashikohet të ndërtohet Vepra e Marrjes së HEC Gjoni

Në figurën 3.7 paraqitet pellgu ujëmbledhës i lumit të Lusës bashkë me atë te përroit të Zallit dhe rrjetin hidrografik i tyre. Në pikën e bashkimit të dy përrrenjve, përroi i Zallit ka një pellg ujëmbledhës prej 70.72 km<sup>2</sup>, ndërsa, përroi i Lusës ka një pellg ujëmbledhës 28.66 km<sup>2</sup>. Në pikën e bashkimit pellgu ujëmbledhës i Lusës është 99.38 km<sup>2</sup>.

Në figurën 3.8 është paraqitur harta hidrogjeologjike (1:25 000) e zonës ku parashikohet ndërtimi i **Hidrocentralit "Gjoni"**, në të cilën janë hedhur edhe pozicionet e nënobjekteve përbërës të këtij hidrocentrali, që është i tipit me derivacion.

Makroformat e relievit të zonës së ndërtimit të hidrocentralit "GJONI", janë me origjinë strukturore –erozionale dhe litologjike. Masivi gjeologjik ku do të ndërtohen objektet e hidrocentralit Gjoni bëjnë pjesë në Depozitimet e Gropës së Burrelit që klasifikohen hidrologjisht në shkëmbinj kompakt me ujëmbajtje mesatare deri në të ulët.

Në lidhje të ngushtë të elementit klimatik tokësor, veshja bimore paraqitet me zonalitet vertikal të dukshëm. Veshja bimore e zonës në studim përbëhet nga brezi i ahut dhe halorëve që shtrihen deri në kuotën 1600 – 1700m. Në katin e halorëve ndikimi i pyllit në rrjedhën

ujore ndihet gjatë gjithë vitit. Në pellgun ujëmbledhës të Lusës shtrihen tokat e murrme pyjore që janë formuar mbi shkëmbinjtë të llojeve të ndryshëm (Figure 6.2).




Figura 3.7 Harta e pellgut ujëmbledhës, lumi Lusës në kuotën 253m




Figura 3.8 Harta hidrogeologjike e zonës dhe Korografia e Hidrocentralit "GJONI"

## → Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit

Hydrocentrali GJONI, parashikon te shfrytëzojë ujërat e pellgut ujëmbledhës të përroit të Lusës, ndërtohet me qëllim prodhimi të energjisë elektrike duke shfrytëzuar një rënie ndërmjet kuotave 253m dhe 165m. Uji merret me anë të një vepre të marrjes (VM) që do të ndërtohet rreth 200m poshtë pikës së takimit të proit të Lusës me proin e Zallit dhe një derivacioni me gjatësi rreth 3.4 kilometër i cili në 1.74 km e parë është në formën e një tuneli pa presion dhe më pas 1.66 km e tjerë janë në formën e një kanali. Ndërtesa e centralit parashikohet të ndërtohet në krahun e djathtë të proit të Shoshaj degë Lumit Mat

Sipas skicë idesë të miratuar në fazën e parafizibilitetit, shfrytëzimi i proit të Lusës ishte parashikaur të bëhet ndërmjet kuotave 253m deri në 165m (Fig.3.9), me një derivacion që shtrihej në bregun e djathtë të proit të Lusës.





Figura 3.9 Korografia e variantit të komponentit të HEC Gjoni sipas studimit të Parafizibilitetit.

Gjatë procesit të miratimit paraprak, për shkak të mos përputhjes së kuotës së bjeftit të sipërm të HEC Gjoni, me kuotën e bjeftit të poshtëm të HEC Doma, që ndërtohet në trungun e proit të Zallit, Ministria në marrveshje me dy investitorët vendosi që kuota e bjeftit të sipërm të HEC Gjoni të zbrësë në kuotën 253m, pra 7m më poshtë.

Për shkak të ndryshimit të rënjes së hidrocentralit Gjoni, pra përkeqësimit të parametrave ekonomikë, Investitori i HEC Gjoni kërkoi që të shihet mundësia që humbja në bjeftin e sipërm të kompensohet me uljen e kuotës në bjeftin e poshtëm.

Po ashtu, në këtë fazë të projektimit të HEC-t, pasi janë bërë studimi i plotë topografik dhe gjeologo-gjeoteknik ka rezultuar se në trasenë e parashikuar në parafizibilitet ka probleme që venë në dyshim qendrueshmërinë e derivacionit, gjë e cila detyroi autorët të ndryshonin aksin

e trasessë së derivacionit, duke tentuar ta shkurtojë atë sa të jetë e mundur dhe mbi të gjitha duke kërkuar një pozicion sa më të favorshëm nga pikpamja e qendrueshmërisë. Kështu pozicioni i ndërtesës së centralit është zhvendosur rreth 1km në drejtim të rrjedhjes së lumit Mat në bregun e djathtë duke garantuar një nivel të nivelit të ujit në dalje nga ndërtesa, kuota 165m mnd.



Harta e Zonave te mbrojtura (Burimi Ministria e Mjedisit).

**Hidrocentrali "GJONI"** parashikohet të ndërtohet ne perroin të Zallit me prroin e Lusës, dhe nëpërmjet një derivacioni me gjatësi rreth 4.5 km, uji dërgohet në Basen të presionit në terracën lindore të luginës së lumit Mat, dhe më tej me anë të një tubacioni me gjatësi rreth 300m dërgohet në ndërtesë të centralit e cila ndërtohet në bregun e djathtë të lumit Mat në afërsi të fshatit Shoshaj.

- E gjithë zona ku parashikohet të ndërtohen nënobjektet e hidrocentralit nuk është e mbrojtur dhe nuk paraqet ndonjë interes të vecantë natyror.
- Të tre variantet e shqyrtuar nuk do të kenë ndonjë ndikim në mjedisin e zonës. Për sejcilin rast është planifikuar grumbullimi i materialeve të ndërtimit dhe sistemimi tyre në pjesën e sipërme të prroit të Shoshaj, ku pas përfundimit të punimeve do të mbillet sipërfaqja me bimë autoktone të zonës. Mbi mbushjet që do të mbulojnë pjesët e tubacionit të turbinave nën sipërfaqen e tokës, do të shtrohet një shtresë vegjetale dhe do të mbillet me bar.

**Sa më sipër grupi i projektimit së bashku me investitorët, është për variantin me derivacion të kombinuar me tunel dhe kanal (figura 9.7), me karakteristika si më poshtë:**

- Kuota e pragut kapërderdhës në veprën e marrjes 250m mnd.
- Prurje llogaritëse e centralit, 3.22m<sup>3</sup>/s
- Tunel derivacioni pa presion, me gjatësi 1740 m dhe pjerrësi tabani 2/1000.
- Kanal derivacioni me gjatësi 1660m dhe pjerrësi 2/1000.
- Dekantues të pozicionuar para basenit të presionit.
- Tubacion turbinash me diametër 1.4m dhe gjatësi 560m.
- Ndërtesë të centralit në bregun e djathtë të prroit të Shoshaj, 350m para derdhjes së tij në lumin Mat dhe me nivel uji në dalje të turbinave 165m mnd.
- Fuqi të vendosur të centralit 2000kW.

**Vepra e marrjes (VM)** ne perroin e Luses eshte e tipit me Dige Nivel Ngritese e cila do te sherbeje po ashtu si shkarkues i ujerave te teperta. Bazuar ne kushtet topografike e gjeologo-inxhinierike, eshte menduar si me i favorshem aksi i vepres se marrjes rreth 100m pas bashkimit te dy perrenjve, atij te Luses dhe perroit te Zallit. Gjeresia e shtratit te lumit ne kete aks eshte rreth 7m. Marrja e ujit do te realizohet me ane te 4 portave metalike, nga ku uji futet direct ne te. Pjese te tjera qe perbejne vepren e marrjes jane: Shkarkuesi i ujerave te teperta, pusi i shuarjes se energjise, shpelaresi ia luvioneve. Ne fazat e metejshme do te jepen detaje te ketyre nenobjekteve dhe llogaritjet hidraulike te bera per kushtet specifike te kesaj veper marrjeje.

**Derivacioni**, i cili eshte pershkruar dhe me siper, do te kete nje gjatesi totale 4074m dhe perbehet nga dy pjese:

**Pjesa e pare**, nje tunel me gjatesi 1788m me permasa bxH=3.5x4.5m. Ne mes te bazes se tunelit parashikohet te ndertohet nje kanal me permasa bxH=1.6x1.8m;

**Pjesa e dyte**, kanal i hapur pa presion me gjatesi 2286m dhe permasa te seksionit terthor bxH=1.6x1.8m; Franko e kanalit eshte pranuar 0.23m. Paralel me kanaline do te kete dhe nje rruge sherbimi me gjeresi minimale 3.5m.

**Baseni i presionit**, do te ndertohet ne fund te derivacionit dhe do te sherbeje si hyrje e tubacionit te turbinave.

**Tubacioni dhe Turbinat**; Dimensionimi i tubacionit te turbinave eshte bere me formulen e diametrit ekonomik duke e kontrolluar per kushte te grushtit hidraulik. Eshte trajtuar percaktimi i numrit te tubacioneve paralel me percaktimin e numrit te turbinave, pra per nje dhe dy tubacione dhe ka rezultuar se variant me optimal eshte ai me nje tubacion turbinash me diameter sipas llogaritjeve DN=1200 mm. Gjatesia e tubacionit ne kete faze eshte 287m.

Per te percaktuar tipin e turbines jane perdorur rekomandimet e prodhuesve te ndryshem. Per karakteristikat e **Hidrocentralit "GJONI"** meprurjeQ=3.30m<sup>3</sup>/s dhe renie neto 69m rezulton qe turbine te jete e tipit FRANCIS. Duke patur synimin qe te arrihet nje shfrytezim sa me i plote i rrjedhjes ujore dhe per te shmangur nderprerjet e plota te punes gjate ndonje remonti te pjesshem, eshte pranuar qe te montohen dy turbine me prurje 1.65m<sup>3</sup>/s secila. Ndertesa e Centralit, parashikohet te ndertohet ne krahun e djathte te Lumit Mat ne afersi te ures ne rrugen nacionale Burrel-Klos. Prurjallogaritese e hidrocentralit do te jete 3.30m<sup>3</sup>/s. Fuqia e vendosur 1940Kw.

E gjykuar nga pikpamja gjeologjinxhinierike ndertesa inkastrohet ne shkembinj ranor dhe konglornerate. Ndertesa e centralit do te jete siperfaqesore.

**Ndertesa e Centralit**, parashikohet te ndertohet ne krahun e djathte te Lumit Mat ne afersi te ures ne rrugen nacionale Burrel - Klos. Prurja llogaritese e hidrocentralit do te jete 3.30m<sup>3</sup>/s. Fuqia e vendosur 1940Kw.

E gjykuar nga pikpamja gjeologjinxhinierike ndertesa inkastrohet ne shkembinj ranor dhe konglornerate. Ndertesa e centralit do te jete siperfaqesore.

Numri i turbinave, dy copë me fuqi të vendosur 1000kW secila




Figura 3.10 Korografia e zonës me variantin e përzgjedhur të HEC GJONI

○ **Karakteristikat klimaterike**

Sipas klasifikimit klimatik të vendit tonë, zona në studim bën pjesë në klimën mesdhetare malore lindore. Zona në studim, për shkak të natyrës së mbyllur, ka klimë relativisht të ftohtë. Në periudhën e ftohtë të vitit ndodh shpesh që masat e ftohta të ajrit të cilat vijnë në këtë sektor qëndrojnë më gjatë në luginën e përroit të Lusës sesa në lartësitë; si pasojë shënohen temperatura mjaft të ulta.

Për të përcaktuar vecoritë klimatike të pellgut ujëmbledhës të përroit të Lusës janë analizuar të dhënat e regjistruara ndër vite nga ish Instituti Hidrometeorologjik për stacionet që rrethojnë këtë pellg, Burrel (309m), Fshat Klos (230m), Qafë Bulqizë (635m), Selishtë (810m) dhe Kurbnesh (760m), etjerë. Stacioni më i afërt dhe më përfaqësuesi është stacioni i Selishtës. Për këtë stacion egziston një seri të dhënash për periudhën 1967 deri në vitin 1990. Në tabelat dhe figurat e mëposhtme jepen temperaturat dhe reshjet atmosferike për stacionin e Selishtës dhe stacionet e sipërpërmendur.

***Temperaturat e ajrit***

Vetë pozicioni gjeografik i zonës krijon kushte të tilla që temperaturat e ajrit, në përgjithësi, të karakterizohet nga vlera mjaft të ulta. Kështu, temperatura mesatare vjetore e ajrit është rreth 9.9°C. Temperaturat mesatare minimale luhaten nga -3.4°C në muajin Janar deri në 13.6 °C në Korrik, ndërsa ato maksimale nga 3.6°C deri në 25.4°C. Përsa i takon çfaqies së temperaturave nën 0°C, mund të themi se ato janë të përvitshme dhe, vrojtohen duke filluar nga fundi i muajit Tetor deri nga fundi i muajit Prill. Mesatarisht vrojtohen rreth 115 ditë me ngrica. Temperatura më e ulët, e matur në stacionin e Selishtës, është -21°C, ndërsa ajo më e larta ka arritur mbi 40°C.

**Reshjet atmosferike vjetore .**

Burimi kryesor që ushqen përroit e Lusës janë reshjet e shiut por ndikojnë sidomos për periudhën e verës edhe liqenet e Hysen Beut, që ndodhen në lartësin 1777 ÷ 1770 metra mbi nivelin e detit.

Në pellgun ujëmbledhës të përroit të Lusës, reshjet atmosferike bien kryesisht në formë shiu dhe pjesërisht në formën e dëborës. Shtresa e dëborës është e madhe dhe e qëndrueshme mbi kuotën 800 m.

Gjatë vitit bien mesatarisht 1378 mm reshje ( reshjet mesatare për territorin e Shqipërisë janë rreth 1400 mm), shifër që flet për një potencial të kënaqshëm uJOR të kësaj zone. Rreth 66% e tyre bien gjatë periudhës së ftohtë të vitit, Nëntor – Mars (Tabela 3.1)



Tabela 3.1 Reshjet atmosferike mujore dhe vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Fushë-Lurë	156	157	141	135	116	76	52	63	101	153	225	215	1590
Selisht	138	121	108	107	90	51	43	46	74	127	164	164	1250
Fshat Klos	159	154	128	115	108	73	47	70	95	118	185	181	1430
Burrel	142	130	116	107	86	60	42	47	78	113	161	159	1240

Muaji më i lagët është muaji Nëntor, në të cilin bien mesatarisht 164 mm shi, ndërsa muaji më i thatë është Korriku, në të cilin bien 43 mm shi.

### ○ Karakteristikat hidrografike

Perroi i Luses ka një sipërfaqe ujembledhese prej  $F = 28.66 \text{ km}^2$  gjatësi të shtratit kryesor të perroit 16 km dhe një pjerresi mesatare të shtratit kryesor  $i\%_o = 33$ . Pellgu ujembledhes i perroit të Luses fillimet e tij i ka rreth kuotes +2021 m m.n.d. perroi mbasi zbret në kuoten 253m, pike ku bashkohet me perroin e Thate merr drejtim dhe derdhet në Lumin Mat.,

Perroi i Zallit ka një sipërfaqe ujembledhese prej  $F = 70.72 \text{ km}^2$ , gjatësi të shtratit kryesor të perroit 20 km dhe një pjerresi mesatare të shtratit kryesor  $i\%_o = 19$ .

Konfiguracioni orografik i zones në studim paraqitet krejtësisht malor dhe i rrethuar me vargmale me lugina shpesh here të thella dhe me rrepara. Hidrografia e perroit të Luses përbehet nga rrjedha ujore (perroska) të pjerrta që tregojnë një orografi malore ku rrjedhjet me uje të rrernbyeshem vihen re me se shumti në periudhën e dimrit dhe të pranverës. Në këtë konfiguracion, karakteristikat kryesore morfometrike të pellgut ujembledhes në veprën e marrjes së ujit për HEC "Gjoni" janë si më poshtë:

- Sipërfaqja e pellgut ujembledhes V.M.  $F = 99.38 \text{ km}^2$
- Gjatësia e aksit (trungut kryesor)  $L = 20 \text{ km}$ .
- Pjerresia mesatare e shtratit të perroit  $i\%_o = 19$ .

Llogaritjet e karakteristikave morfometrike u bënë mbi bazën e hartave 1:25000.

○ **Relievi dhe gjeomorfologjia**

**Hidrocentrali “Gjoni”** planifikohet të ndërtohet në segmentin lumor ndërmjet kuotave 253 dhe 165 m mbi nivelin e detit me vepër marrjeje në pikën e bashkimit të prroit të Lusës me prroin e Zallit dhe ndërtesë të centralit në bregun e djathtë të lumit Mat, në afërsi të fshatit Shoshaj.

○ **Hidrologjia e zones**

Kushtet hidrogjeologjike të basenit ujëmbledhës të përroit të Lusës (rrjedha e poshtëme), kanë ndikim të rëndësishëm në parametrat e hidrocentralit, vecanërisht për vlerësimin hidrogjeologjik të veprës.

Kufiri lindor i pellgut ujëmbledhës përfaqësohet nga një rafshnaltë me gropëzime në formën e liqenjve alpin të cilët furnizojnë me rrugë sipërfaqësore dhe nëntokësore dy degët kryesore të këtij pellgu. Në figurën 3.12 jepet harta hidrogjeologjike e zonës (marrë nga harta hidrogjeologjike e Shqipërisë sh. 1:200 000), nga e cila shihet se në pellgjet ujëmbledhës të Lusës dhe Zallit ka një numër burimesh shumica e të cilëve janë sezonal. Theksojmë se njëri nga këta burime, në afërsi të fshatit Vinjol, ka rrjedhje të vazhdueshme. Ky burim ka shumë vite që përdoret për të furnizuar ujësjellësin e qytetit të Burrelit me një prurje 35-40l/s. Nga matjet e bëra në këtë burim në periudhën 1968-1990, rezulton që prurja mesatare e tij është e rendit 270l/s.




Figura 3.12. Harta hidrogjeologjike e pellgut të përroit të Lusës

Faktorët hidrogjeologjikë të trojeve të gropës tortoniane të Burrelit, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në kushtet gjeologjiko – inxhinierike të vendndërtimeve të veprave të hidrocentralit. Shtresat ranorike dhe alevrolito – mergelore të prerjeve litologjike të kanioneve të përrrenjve që përfshihen në projektin e hidrocentralit GJONI, janë me parametra shumë të ulët të ujëpërshkueshmërisë  $k \sim 1 \times 10^{-5} - 1 \times 10^{-6} \text{ cm/sek}$ . Si rrjedhojë ujjat e mirëfilltë nëntokësorë nuk ndikojnë në kushtet gjeologjiko – inxhinierike të veprës.

Ndikim të rëndesishëm në kushtet gjeologo – inxhinierike të veprave të hidrocentralit për tunelin e derivacionit, kanë ujrë e infiltrimit vertikal të reshjeve në tokë. Pavarësisht vetive të ulta të ujëpërshkueshmërisë të shtresave sedimentare të kanioneve (pa konglomerate), ujrë e infiltrimit vertikal depërtojnë në shtresat nëpërmjet mikroçarjeve dhe mikroporozitetit efektiv të këtyre shtresave.

Vijat e infiltrimit vertikal të reshjeve kushtëzojnë përjarrimin dhe tjetërsimin e shpejtë të shtresave alevrolito – mergelore të sipërme. Si rrjedhojë e këtyre ndikimeve duhet që në projekt të parashikohen masa inxhinierike të veçanta në tunelin e derivacionit dhe në skarpatat e gërmimeve të ndryshme.

### ○ Kushtet gjeologo-inxhinierike të zonës

Gropa e Burrelit, depresioni strukturor tektonik Rëshen – Burrel, përfaqëson një dukuri të vecantë gjeologjike sikurse janë edhe të tjera dukuri të ngjashme në Shqipëri. Në gropën e Burrelit ndeshen depozitime sedimentare me moshë gjeologjike tortoniane ( $N_1^{2t}$ ), si depozitime liqenore, ose depozitime të një deti paratoronian që ka dominuar zonën e ulësirës pranë adriatike perëndimore.

Në prerjet litologjike të kanioneve të përrenjve në anën lindore të lumit Mat, ndeshen dy tipe litologjike të shtresave sedimentare me përqasje subhorizontale. Nga kuotat e shtratit të përrenjve dhe deri 20 – 40 m lartësi të shpateve të kanioneve ndeshen shtresa potente ranorike me ngjyrë gri dhe gri në bezhë. Mbishtuar bankove ranorike ndeshen shtresa gjithashtu potente të përbëra nga alevrolite dhe alevrolito – mergelore me ngjyrë gri të kaltër. Shtresëzimet ranore janë të zhveshura në pjesët subvertikale të kanioneve. Nërsa shtresëzimet alevrolito – mergelore janë me mbulesa eluvialo – deluviale të shpatit me pjerësi mesatare në kuotat më të sipërme të kanioneve të përrenjve.

Ky dallim në shpatet e kanioneve të përrenjve (figure 3.13), është rrjedhojë e shkallës së ndryshme të litifikimit relativisht të fortë të ranorëve në raport me shkallën e ulët të litifikimit të shtresave alevrolite dhe mergelore. Ky tipar gjeomorfologjik i shpateve të kanioneve është tipik në gjithë terracinin lindor akumulativ të luginës së gjerë të lumit Mat në gropën e Burrelit. Si rrjedhojë e këtyre rregullsive të ndërtimit gjeologjik në kanionet e përrenjve të lumit Mat në juglindje të Burrelit, profilet gjeologo – inxhinierike të veprave të hidrocentralit rezultojnë të jenë të sakta.

Figura 3.12 Harta Hidrogjeologjike e zonës ku përfshihen objektet e HEC Gjoni



*Foto 3.13. Shpati i djathtë i kanionit të përroit të Lusës, pakot ranorike – 2; dhe pakot alevrolite e mergelore – 2/1.*

Midis shtresave potente ranorike ka ndërshtresa të holla 0.5 – 1.5 m me përbërje alevrolito – mergelore. Këto ndërshtresa të holla kanë ndikim të pa rëndësishëm në kushtet e stabilitetit meqënëse shtresëzimi është horizontal. Gjithashtu edhe në shtresat potente alevrolito – mergelore ka ndërshtresa ranorike me trashësi deri në 2.0 – 2.5 m.

○ **Lidhja e hidrocentralit me rrjetin energjetik**

Ne perzgjedhjen e menyres se lidhjes do te merren ne konsiderate humbjet e energjise, te nivelit te tensionit, investimet dhe sigurine e punes te kompleksit energjetik te hidrocentralit. Ne zgjedhjen e variantit optimal ndikon edhe gjendja e rrjetit elektrik ne zone dhe nenstacioneve elektrike qe mund te jene. Nenstacioni elektrik me i afert eshte nenstacioni 110/10kV Suç.

○ **Impakti ne mjedis I ndertimit te linjes se transmetimit**

Studimi ndermerret per te gjetur menyren me te mire per lidhjen me sistemin elektrik te Hidrocentralit Gjoni. Studimi eshte kryer duke mbajtur ne konsiderate kriteret e meposhtme:

- Traseja e linjes elektrike te kaloje ne formacione gjeologjikisht te qendrueshme
- Traseja te jete e shmangur nga vendbanimet dhe te jete larg shtepive apo objekteve te ndryshme sociale, te bizneseve dhe pronave te tjera te patundshme
- Terreni ku kalon traseja te kete sa me shume akses ne infrastrukturen rrugore, per kushte lehtesuses gjate ndertimit dhe ne kohën e shfrytezimit te kesaj linje.
- Niveli i tensionit dhe humbjet e fuqise te jene ne kufij te pranueshem.
- Mundesisht te mos intersekoje linja elektrike apo objekte infrastrukture.

Zona ku do te ndertoet Hidrocentrali GJONI furnizohet me energji elektrike me linjen 10kV nepermjet Fiderit qe del nga nenstacioni Suç 110/10 kV. Nga ky fider ushqehen fshatrat Suç, Kurdari etj.

FideriN/Stacionit110/10 kV Suç deri ne piken fundore ka nje gjatesi 10km.  
LinjangaHEC GJONI deri ne N/Stacionin110/10 kV Suç ka nje gjatesi 3km.  
Niveli i tensionit tek perdoruesit fundor eshte i ulet, pervete gjatesine e madhe te linjes se transmetimit te energjise elektrike.

Linjat elektrike qe ushqehen nga fideri jane si me poshte:

- Magjistrali ngaN/stacioni 110/10 kV Suç deri te kabina e fundit eshte 10km
- Degezimet jane 5km
- Dalja nga N/stacioni 110/10 kV Suç eshte me kabell T.M.XLPE;AL 3x10kV
- N/stacioni 110/10 kV Suç ka transformatore 2x5.6MVA.

Ndikimi ne peisazh eshte i pritshem, por shkalla e ndikimit eshte e paperfillshme, kjo per vete natyren e punimeve.

Duke qene se zona ku kalon traseja eshte e zhveshur kjo nuk do te ndikonte ne tjetersim peisazhi. Sqarojme, se shkalla e ndikimit ne peisazh eshte ne nje nivel shume te vogel dhe ne shume vende i paperfillshem. Vleresohet qe ky projekt nuk do le kete nderveprime me mjedisin dhe as ndikime potenciale/thelbesore ne elementet perberes te tij.

Ndikimet e mundshme ne mjedis le linjes ndodhin si gjate fazes se ndertimit ashtu edhe gjate operimit. Qe ne fillim duhet le theksojme qe per vete specifiken e tij si linja e

transmetimit dhe impianti i transformimit të energjisë elektrike nga një nivel tensioni në një tjetër ndotjet që i shkaktohen mjedisit janë minimale.

Një nga efektet më të diskutueshme të një linje nënstationi apo një grup linjash të tensioneve të ndryshme janë efektet e fushave elektrike dhe magnetike në qeniet njerezore dhe mjedisin në përgjithësi. Veprimtaria e punës gjatë ndërtimit të shfrytëzimit të kësaj linje elektrike, do të jetë në përputhje të plotë me projektin e miratuar. Zbatimi i saktë i masave për ruajtjen e përmirësimin e mjedisit në objekt do të ndikojë pozitivisht në punësimin e zonës.

Përfundimisht, theksojmë se me këtë projekt, duke zbatuar kërkesat ligjore dhe rekomandimet e këtij vlerësimi, subjekti arrin të realizojë një veprimtari të saktë dhe sipas kërkesave për mjedisin, ku krahas ndikimit në përmirësimin e situatës energjetike dhe zbatimit të efektëve sociale siguron një mjedis të pastër për zonën rreth.

Ky projekt nuk do të ketë ndërvprime me mjedisin dhe as ndikime të mundshme/thelbesore në elementet e ndërtimit të tij. Gjatë ndërtimit të linjës do të ketë hapje të gropave dhe sasi të vogël dherash të gërmuar.

Një sasi e caktuar dhe të gërmuar si rezultat i hapjes së gropave për vendosjen e bazamentëve të shtyllave do të krijohet perkoheishtë. Një pjesë e kësaj dhe do të risistemohet në terrenet rreth shtyllave mbas punimeve. Megjithatë çdo pjesë shume e vogël e mbetur do të largohet nga sheshi dhe do të depozitohet në vendin e caktuar si shesh depozitimi për të cilin investitori i H/C-it, do të ketë miratimin mjedisor përkatës për këtë qëllim. Harta e linjës elektrike bashkëlidhur VNM-se


#### • **Infrastruktura e zonës dhe rrugët lidhëse**

Për ndërtimin e këtij hidrocentrali është parashikuar të shfrytëzohet infrastruktura rrugore ekzistuese, e cila do të rehabilitohet dhe përfordhet sipas rastit duke parashikuar parashikimet që do të transportohen konkretisht gjatë ndërtimit të kësaj veprë hidroteknike.

- Në figurën 11.17 jepet infrastruktura rrugore nga ku vëhet re se:
- Për ndërtimin e veprës së marrjes dhe pjesës së parë të tunelit të derivacionit, futja do të bëhet nëpërmjet rrugës së asfaltuar të Kurdarisë, degëzimi i të cilës në 800m e parë është ekzistues dhe shërben si rrugë fshati për një lagje të Fshatit Kurdari. Më tej deri në aksin e veprës së marrjes ekziston një rrugë shërbimi e pashtuar pjesë e sitemit rrugor të bujqësisë. Pjesa e parë e rrugës me gjatësi 800m do të rehabilitohet duke rindërtuar shtresat e saj, rrugë e cila do të përmirësojë kushtet e transportit të komunitetit rreth. Pjesa tjetër me një gjatësi prej 1700m do të rikonstruktohet duke e bërë të përshtatshme

për ndërtimin e objekteve të këtij hidrocentrali por edhe për të shërbyer më vonë si rrugë shërbimi si për hidrocentralin edhe për komunitetin përreth.

- Për ndërtimin e Basenit të presionit, Dekantuesit, Kanalit të Derivacionit dhe Tunelit të derivacionit në dalje të tij, futja do të bëhet nëpërjet rrugës egzistuese të pashtuar ndërmjet fshatit Shoshaj dhe Mallunxë. Kjo pjesë rruge me gjatësi 600m do të rehabilitohet duke rindërtuar shtresat e saj, rrugë e cila do të përmirësojë kushtet e transportit të komunitetit përreth. Më tej traseja e Derivacionit do të shërbejë si rrugë për futjen dhe ndërtimin e nënobjekteve si Dekantues, basen Presioni, kanal dhe tunel Derivacioni. Paralel me kanalin e derivacionit është parashkuar të ketë një rrugë shërbimi për monitorimin e këtyre nënobjekteve pas vënjes në funksion të hidrocentralit.
- Për ndërtimin e ndërtesës së centralit do të hapet një rrugë e re me gjatësi 200m si zgjatim i rrugës egzistuese të grupit të shtëpive pranë qendrës sëndetsore të fshatit Shoshaj.



Figurë 3.24 Korografia e rrjetit rrugor për ndërtimin e Hidrocentralit Gjoni.

Në po të njëjtën figurë 3.24 janë paraqitur edhe katër vend depozitime të materialeve që do të dalin nga gërmimet për të cilat do të merret leje nga Njësia Vendore së bashku me lejet e tjera.

Njëri nga këta venddepozitime do të jetë një tarracë në anën e majtë të lumit Lusë, ku do të depozitohen materialet që do të dalin nga gërmimet e veprës së marrjes dhe një pjesë e tunelit të derivacionit.

Tre vend depozitimet e tjerë do të jenen në tre prrocka që intersekojnë kanalin e derivacionit. Në këto tre prrocka do të ndërtohen prita me material rrethor për të krijuar volumin e nevojshëm të materialit që do të depozitohet.

#### **4. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ**

##### **○ Statusi i zones ne studim**

Fshatrat qe perfshihen ne kete zone, sot ushqehen keq me energji elektrike si rezultat i defekteve te mundshme. Me ndertimin e ketij hidrocentrali do te kemi permiresime te ndjeshme sasiore dhe cilesore per zonen.

Si kudo dhe ne kete zone mjaft banore kane emigruar per shkak te mungeses se punes.

Ndertimi i hidrocentralit ne kete zone do te krijojte mundesine e hapjes se vendeve te punes, per rrjedhoje hapja e ketij aktiviteti do te zbuste sadopak plagen e papunesise duke ndikuar dhe ne emigracionin e zones.

##### **○ Variantet e zhvillimit ne perspektive.**

Nevojat per energji elektrike vijne gjithnje ne rritje. Duke pare bilancin sot rezulton se ne vend konsumohet shume me teper energji elektrike se sa prodhohet. Kjo diference mbulohet me import, i cili ndikon ne bilancin ekonomik si dhe ne vartesine nga te tjeret per plotesimin e nevojave brenda vendit.

Per te plotesuar nevojat gjithnje e ne rritje ndermjet te tjerave rol kryesor luan dhe shfrytëzimi me eficence i kapaciteteve ekzistuese, per te punuar me ngarkese mesatare dhe ne pik. Kjo do te beje qe te kemi impakt pozitiv duke lehtesuar shkembimin e energjise.



Mbeshtetur ne investimet qe do te realizohen do te kemi nje shtim te kapaciteteve prodhuese te energjise elektrike.

Nderkohe duke perfshire ne projekt ndertimin e linjave te tennsionit te latte te transmetimit te energjise, do te kemi dhe nje ulje te ndjeshme te humbjeve teknike, po keshtu zona apo rajoni do te furnizohet me energji elektrike me parametra nominale.

Rrjeti transmetues eshte pergatitur ne menyre te tille qe te mbuloje nevojat me kosto minimale, humbje minimale, ndikim minimal ne mjedis dhe me sherbim cilesor dhe te mjaftueshem.

Nderimi i hidrocentralit dhe kalimi direkt i prodhimit te energjise ne linjen e transmetimit te energjise elektrike, behet ne menyre te tille qe te plotesohen nevojat e zones ne fjale me nje kosto minimale dhe ndikim minimal ne mjedis dhe te permiresoje parametrat e sistemit energjetik.

#### ○ **Mendimi i komunitetit.**

Per zbatimin e ketij projekti Shoqeria **"REDEN" Shpk**, i ka kushtuar nje vemendje te vecante bashkepunimit me pushtetin vendor. Që në fillim te studimeve perkatese per kete projekt eshte marre kontakt me drejtuesit e komunave perreth, duke kerkuar miratimin ne parim te projektit per ndertimin e hidrocentralit. Lidhur me mendimin e komunitetit per vendimarrjet mjedisore baza ligjore qe i referohemi eshte VKM Nr.994 date 02.07.2008 "Per terheqjen e mendimit le publikut ne vendimarrjen per mjedisin" si dhe VKM Nr. 247, date 30.4.2014" Per percaktimin e rregullave le kerkesave dhe procedurave per informimin dhe per.fshirjen e publikut ne vendimarrjen mjedisore"

Nga zbatimi i ketij projekti do te perfitohet:

1. Prodhimi i energjise elektrike
2. Krijimi i mundesive dhe kushteve optimale per shfrytezimin e ketyre ujerave per plotesimin e nevojave te kornunitetit dhe te gjithë sektoret e tjere te ekonomise.
3. Qendrushmeri e rrjedhjes ujore si gjate periudhes se laget ashtu edhe asaj te thate te vitit.

#### ○ **Planet e zhvllimit urban te zones.**

Zhvillimi i kesaj hapesire parashtron disa kerkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendimarrsesve. Projekti i ndertimit te **Hidrocentralit "Gjoni"** gjithmone duke minirizuar efektet negative ne peisazhin e kesaj zone, dote kontribuojne ne furnizimin me energji elektrike te panderprere dhe me parametra te mire.

○ **Ekosistemet, peisazhet dhe peisazhi egzistues.**

Zona ku do te ndertohet hidrocentrali "Gjoni" ka nje peisazh terheqes te nje zone malore. Ndertirni i hidrocentralit nuk do te demtoje e prishe peisazhin apo ekosistemet ekzistuese. Kjo zone me floren karakteristike, formon nje sistem ekologjik shume interesant e me vlera te vecanta mjedisore.

